



**Rrjeti i Monitorimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore** paraqiti në para-sesionin e Raportit UPR për Shqipërinë disa çështje dhe rekomandime për përmirësimin e situatës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj gruas dhe dhunës në familje në Shqipëri.

Para-sesioni u zhvillua sot, më 4 Prill 2019, ora 09.00-10.00, në Pallatin e Kombeve, në Gjenevë.

Përfaqësuesja e rrjetit, Av. Aurela Anastasi, parashtrori disa shqetësime lidhur me progresin e bërë deri tani nga Shteti Shqiptar dhe paraqiti disa rekomandime për të përmirësuar situatën e mbrojtjes së grave dhe vajzave nga dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje.

Vëmendja iu kushtua ngritjes dhe forcimit të mekanizmave shtetërorë me qëllim zbatimin me efektivitet të akteve të miratuara në kuadër të reformave ligjore për përmirësimin e legjislacionit kundër dhunës në familje dhe ndihmës ligjore të garantuar nga Shteti, si dhe hartimit të ligjit kuadër për mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore. Në këto rekomandime u përfshi edhe përshpejtimi i zbatimit të reformës në drejtësi, pasi forcimi i institucioneve të drejtësisë ndikon në zgjidhjen e problemeve të situatës në lidhje me dhunën ndaj gruas dhe dhunës në familje. Si një shqetësim kyc u shpreh shtrirja e veprimtarisë së mekanizmave shtetërore në të gjitha bashkitë e vendit dhe mbështetja e grave në zonat rurale për denoncimin e dhunës në familje. Ndërkohë Shteti Shqiptar duhet të vendosë prioritet zbatimin me efektivitet të ligjeve të reja, me qëllim që të ngushtohet dallimi i krijuar aktualisht midis standardeve ndërkombëtare të adoptuara në hartimin e ligjeve dhe dobësisë së institucioneve për zbatimin e tyre.

Në një vështrim të përgjithshëm të kontributit të të gjithë panelistëve (folën përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile kombëtare e ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri dhe përfaqësuesi i Avokatit të Popullit), rezultoi se çështja që mori më shumë vëmendje ishte mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe aktivizmi i të rinjve në shoqëri.

Në prezantimin e Rrjetit tonë u ngritën çështje që kishin të bënin me të rinjtë e fëmijët. Vlen të përmendet ndërjegjësimi dhe edukimi ligjor i të rinjve, nxënës të shkollave, etj., me qëllim denoncimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe përmirësimi i programeve mësimore para-universitare në lidhje me njohuritë dhe diskutimet që zhvillohen për këto çështje.